

Data 12.09.2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:”Blerje materiale dhe pajisje komutuese TM/TU per Kabina”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KODI CPV - materiale elektrike -31681410-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

-193,933,667 (njeqind e nentedhete e tre milion e nenteqind e tridhete e tre mije gjashteqind e gjashtedhete e shtate) leke pa TVSH ose: konvertuar ne vleren 1,814,669 (nje milion e teteqind e katermbedhete mije e gjashteqind e gjashtedhete e nente) Euro bazuar ne kursin e kembimit date 12.09.2023 (1 EUR = 106,87 ALL.

Ndarje ne Lote - s”ka

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSSH sh.a Drejtoria Rajonale Tirane” ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
 - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.
- Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane OSSH Sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Kjo procedurë është e pamundur teknikisht të ndahet në lote sepse nga vete objekti i prokurimit kemi të bëjmë vetëm me një lloj të vetëm furnizim mallrash (**Blerje paisje për nyjet komutuese**) të cilat klasifikohen në të njëjtën familje të mallrave objekt prokurimi.

Kontraktuesi që do të ofrojë këto pajisje, duhet të zoterojë manualeve të detajuar të instalimit, operimit dhe mirëmbajtjes dhe dokumenteve të tjera të specifikuara në Specifikimet Teknike. Për këto arsye, të gjitha proceset e këtij furnizimi, që të funksionojnë dhe të meren në dorezim në kohe me cilësi dhe garancinë e nevojshme duhet të realizohet në një procedurë të vetme dhe për përgjegjësinë e proceseve nga një operator ose bashkim operatorësh. Është e pamundur që kjo procedurë të ndahet në lote nga vete natyra e saj, si dhe për arsye të koordinimit të grupeve për proceset e punës që do të kryhen.

Për sa mesiper dhe për të shmangur shumë procese që mund të lindin, kjo procedurë nuk është e mundur të ndahet në lote por duhet të bëhet nga një OE për arsye dhe të garancojë se defektit

AK gjykon se ndarja në lote e kontratës së mësipërme nuk është praktike, pasi furnizimi i kërkuar nuk mund të copëzohet për shkak se mallrat objekt prokurimi janë një i vetëm dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 parashikohet shprehimisht se: *“Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike,

financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me një familje mallrash të vetme dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2020, 2021, 2022 të konfirmuara me vule prane administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.1.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës Nr.8 të DST.

Argumentimi për pikat 2.1.1, 2.1.2, 2.1.3: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet*

kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Vlera e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entitet kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Objekti i kësaj kontrate konsiston në "Blerje materiale dhe pajisje komutuese TM/TU për Kabina", ku pajisjet komutuese konsiderohen pajisje teknologjike delikate dhe të domosdoshme për shërbimin normal të rrjetit të shpërndarjes. Duke marrë në konsideratë për sa mesipër, ku theksohet rëndësia e këtij shërbimi, gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e parashikuar të cilave na kalon në "Procedurë mbi kufirin e lartë monetar", afatet e të cilave shtrihen në kohë, në mënyrë që autoritetit/entitet kontraktor të njohë gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, për një konkurrencë sa më të fortë dhe gjithëpërfshirëse, është përcaktuar dhe vlera e mesipërme

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 43 pika 2/a të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 .

Gjithashtu në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vertetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 39% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, në sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e kërkuar që është brenda vlerës së përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë jo më e vogël se 39% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.2.2 Dokumentacioni

Per mallrat objekt prokurimi : Blerje materiale dhe pajisje komutuese TM/TU per Kabina”.

.

Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim te prodhuesit / distributorit per cdo artikull te kerkuar (sipas preventivit). Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument te paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar ne gjuhen zyrtare shqipe.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, Operatori Ekonomik duhet te paraqese: Katalogun/et ose fragmente te katalogut /eve te prodhuesit/ve per mallrat objekt prokurimi ku te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. *Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

Argumentim: Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera per mallrat objekt prokurimi te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e mallrave te prodhuara (lista e mesiperme e mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen qe ti sherbejne AK-se, per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te OE-ve, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme si aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur si dhe cdo element tjetër ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne permbushje te kriterit te mesiperme, Operatoret Ekonomike, duhet te paraqesin deshmi te testimave zyrtare te kryera, leshuar nga institucione te autorizuar, ose nga prodhuesi, per mallrat e cituar me sipër, per te krijuar bindjen se malli i ofruar eshte brenda parametrave te kerkuara. Eshte ne te drejten e AK te kerkoje deshmi per rezultatet e testimave zyrtare qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike te vendosura, perpara se AK te beje perzgjedhjen e OE-se

fituese. Kjo kerkese eshte ne perputhje me piken 6/c, te nenit 40 te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

4. Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatën e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe ka lidhje me objektin e kontrates, si me poshte:

- a) ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) në fushën e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit;

Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomike, secili anetar duhet te paraqese certifikaten ISO

Argumentimi: Ne lidhje me kërkesën qe OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikaten e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001 eshte e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyren dhe vleren e kontrates, me qellim per te vertetuar dhe te garantoje realizimin ne kohe, me sukses dhe me cilesi sipas standarteve nderkombetare te objektit te kontrates. Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

5. Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklaron se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesit / ve eshte sipas standartit ISO 9001 – 2015 (ose ekuivalente) dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara.

Argumentimi: Ky kriter eshte kerkuar pasi vetëm prodhuesi mund të vërtetojë se produktet e prodhuara kanë në fakt, karakteristikat e deklaruar. Certifikata e sigurimit të cilësisë ka për qëllim të plotësojë deklaratën fillestare apo certifikatën e përshtatshmërisë. Si provë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e produktit, prodhuesi pajiset me certifikatën për cilësinë e sistemit të kontrollit i cili monitoron fabrikimin e produkteve të caktuara. Këto certifikata bazohen në standardet ndërkombëtare ISO 9001: 2000.

6. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deklarate konformiteti ku te shprehet qe materialet te kene markim CE.

Argumentimi: Kërkesa per paraqitjen e deklarates se konformitetit per produktet qe kerkohen me siper, eshte nje kerkese e lidhur ngushtesisht me objektin e kontrates dhe duke qene se, Autoriteti Kontraktor eshte perfitues direkt i kontrates objekt prokurimi eshte ne te drejten e tij te garantohet se OE-te pjesemarres i plotesojne kerkesat e cilesise se mallit qe do te ofertohtet, rrjeshimisht eshte e drejte e AK-se tu kerkoje ofertuesve qe te paraqesin deklarate per te vertetuar konformitetin prodhimit te produkteve te procedures e prokurimit. Per Autoritetin Kontraktor eshte e nevojshme qe, Operatoret ekonomike gjate ofertimit te tyre te provojne se zoterojne kapacitetet teknike lidhur me deklaratën e konformitetit per artikujt e kerkuara me siper. Kërkesa

e mesiperme ka si qëllim të sigurojë AK-ne, mbi aftësitë teknike të OE fitues në drejtim të përmbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standardeve të mirepërcaktuara në DST. Ky kriter nuk është diskriminues dhe është proporcional me objektin e kontratës, si dhe është në zbatim të Nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë skicat elektrike dhe skemat e montimit.

8. Operatori ekonomik/ofertues duhet të paraqesë tabelat me të dhënat teknike të mallrave të kërkuara të plotësuara dhe firmosur nga prodhuesi.

9. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin mostrat e mallrave për tipet e kërkuara, nga prodhuesi i ofruar në momentin e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale Tiranë OSSH sh.a. Ofertuesit duhet të paraqiten në oren e caktuar në lajmerimin e bërë nga AK nëpërmjet sistemit elektronik, përkatësisht:

a. Cila linjë me ndares ngarkuese, me gaz SF6 630A

b. Cila transformatori me ndares ngarkuese, me gaz SF6 630A dhe siguresë

c. Paneli i vendosur jashtë me 4 dalje automat 1x100+4x250A

Mosplotësimi i këtij kriteri përben kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen që të shërbejnë AK-së sipas referimeve të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 nëni 40 paragrafi 6 i të cilit përcakton: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.*

Njësia e Prokurimit gjykon se qëllimi i vendosur për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga autoriteti kontraktor në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Theksojmë se mostrat për produktet e kërkuara më lart nuk janë të ekzagjeruara në numër dhe dorëzimi i tyre është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi

10. Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin / Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. *Specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i specialisteve sipas standarteve, te derguara nga Drejtoria Qendrore, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.*

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë:

Data 13.10.2023 Ora 11.00

Vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

